



1. **Butoni Regjistrimit:** Fillimisht gjeni dhe shtypni butonin "Regjistrohu".



2. **Leximi i Informacioneve:** Para se të vazhdoni me regjistrimin është esenciale të lexoni me kujdes të gjitha informacionet e detajuara (edhe nëse fëmija është ish-kampist).
3. **Regjistrimi:** Nëse jeni dakort me kushtet në informacionet e parashtruara dhe dëshironi të vazhdoni me hapin tjetër të procesit, shtypni butonin "Kliko për tu Regjistruar".
4. **Formulari i Regjistrimit:** Në formularin e regjistrimit që shfaqet, plotësoni saktësisht sipas kërkesave, të dhënat tuaja personale dhe të fëmijës që do të marrë pjesë.
5. **Butoni "Next":** Nëse butoni "Next" nuk aktivizohet, kontrolloni formularin për t'u siguruar që nuk keni lënë asnjë hapësirë boshe pa plotësuar.
6. **Shërbimet Shtesë:** Të gjitha shërbimet shtesë të ofruara janë opsionale sipas dëshirës tuaj.
7. **Konfirmimi:** Kusht për konfirmimin e të dhënave është të lexoni dhe të pranoni Termat e Kontratës dhe Rregulloren e "KH Summer Camp".
8. **Pagesa dhe Shkarkimi i Faturës:** Pagesa preferohet të kryhet online ose me transfertë bankare, por mundeni edhe cash. Pas pagesës, ju do të keni mundësinë të shkarkoni faturën direkt nga faqja web ose përmes email-it të dërguar.
9. **Afati i Pagesës:** Nga momenti i gjenerimit, faturat për pagesat cash ose transfertë bankare, kanë një afat vlefshmërie 3-ditore. Në të kundërt formulari i plotësuar nuk do të merret në konsideratë.
10. **Konfirmimi i Regjistrimit:** Pas përfundimit të pagesës, do të njoftoheni përmes një email-i konfirmimi për përfundimin e suksesshëm të regjistrimit dhe pagesës.

SHËNIM: Ju lutemi nëse ende hasni vështirësi në plotësimin e formularit të regjistrimit, mos nguroni të na kontaktoni në numrin tonë të telefonit +355 69 707 7400.